

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Menaxhimi i Performancës**

**P8**

Nr.

**Zgjidhja**

FLETË PROVIMI

Exam Paper

Data/Date

13.07.2024

**PËRMBAJTJA/CONTENT**

| <b>Pjesa/Session</b>  | <b>Maksimumi i dhënë / Maximum assigned</b> | <b>- Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-<br/>PIKËT E DHËNA<br/>- Attention! This part is for SCAAK use only-<br/>MARKS</b> |
|-----------------------|---|---|
| 1. Problemi/Problem 1 | 20  |   |
| 2. Problemi/Problem 2 |   |   |
| Pjesa/Part (a)        | 10  |   |
| Pjesa/Part (b)        | 10  |   |
| 3. Problemi/Problem 3 | 20  |   |
| 4. Problemi/Problem 4 | 20  |   |
| 5. Problemi/Problem 5 | 20  |   |
| <b>Gjithsej/Total</b> | <b>100</b>                                  |   |

## Problemi 1

Kompania FIT prodhon pajisje për ushtrime trupore me të cilat i furnizon klubet sportive dhe qendrat për ushtrime trupore në regjion. Kompania ka reputacion për ndryshimet e vazhdueshme që i bënë në dizajnin e pajisjeve që i prodhon duke ju përshtatë kërkesave të klientëve. Për këtë arsye kompania mbanë pozitën e liderit në këtë industri megjithëse produktet e saj kanë një cikël të shkurtër të jetës. Për produktin e ri NRG500 për të cilin janë bërë hulumtimet është përgatitur raporti për menaxhmentin, detaje të të cilit janë shpalosur në vazhdim:

- Nëse miratohet projekti, NRG500 parashikohet të filloi prodhimin në fillim të vitit duke i përcaktuar vëllimin e prodhimit dhe shitjeve për vitin e parë në 7,000 njësi, për vitin e dytë 8,400 njësi dhe për vitin e tretë 6,750 njësi.
- Kostot e materialeve vlerësohen të jenë €200 për njësi në vitin e parë. Si rezultat i kontratave afatgjata të furnizimit me furnitorët, këto kosto do të reduktohen për 2.5% në fillim të vitit të dytë, dhe reduktim të mëtejshëm prej 2% në fillim të vitit të tretë (në bazën e vitit të dytë).
- Pritet që gjatë një ndërrimi (8-orësh) të punës përgjatë vitit të parë të prodhohen nga 10 njësi të NRG500. Ndërsa stafi bëhet më i njohur me procesin e prodhimit, pritet që produktiviteti të rritet me 5% në vitin e dytë (bazuar në vitin e parë) dhe me 4% në vitin e tretë (krahasuar me vitin e dytë). Kostot totale të punës që do të ngarkohen njërive të prodhuara përgjatë një ndërrimi të punës pritet të arrijnë vlerën prej €800 në vitin e parë. Stimulimi për përmirësim të produktivitetit përgjatë vitit të dytë parashihet të jetë 2.375% (mbi bazën e vitit të parë) dhe rritje të mëtejme prej 4% në vitin e tretë (mbi bazën e vitit të dytë).
- ShPP variabile që u ngarkohen produkteve të prodhuara përgjatë një ndërrimi të punës pritet të arrijnë vlerën prej €600 në vitin e parë. Këto kosto pritet të rriten për 1.5% në vitin e dytë (krahasuar me vitin e parë) dhe për 4% në vitin e tretë (krahasuar me vitin e dytë).
- ShPP fikse të alokuara për produktet e prodhuara në vitin e parë vlerësohen në €560,000 dhe pritet që në vitin e dytë, të rriten për 12.5% (krahasuar me vitin e parë) dhe në vitin e tretë për 3.5% (krahasuar me vitin e dytë).
- Hulumtimet kanë treguar se çmimi i shitjes prej €520 për njësi në vitin e parë dhe €505 për dy vitet tjera do të çojë në arritjen e vëllimeve të shitjeve të parashikuara.
- Menaxhmenti ka përcaktuar normë minimale të kthimit në fitim **përgjatë ciklit jetësor** të produktit prej 17% për produktet e reja për të miratuar fillimin e prodhimitarisë.

### Kërkohet:

- a. Të llogaritet kostoja totale për njësi të NRG500 për secilin vit; **15 pikë**
- b. Të llogaritet fitimi i përgjithshëm në vlerë monetare dhe koeficienti i fitimit për **secilin vit** dhe për **gjithë ciklin jetësor** të produktit NRG500. Komentoni pranueshmerinë e investimit bazuar në rezultatet e për secilin vit dhe për gjithë ciklin jetësor të produktit krahasuar me normën minimale të kthimit në fitim të përcaktuar nga ana e menaxhmentit; **5 pikë**

**Kujdes:** Saktësia e rezultateve në Problemin 1. janë bazë për llogaritjet dhe saktësinë e rezultateve në Problemin 2. a.

## Zgjidhja

a. Llogaritja e kostos totale për njësi të NRG500 për secilin vit:

|                                 |                          | Viti 1        | Viti 2                | Viti 3                |            |
|---------------------------------|--------------------------|---------------|-----------------------|-----------------------|------------|
| Njësi (për t'u prodhuar)        |                          | 7,000         | 8,400                 | 6,750                 |            |
| <b>Materialet direkte</b>       |                          | <b>200.00</b> | Ulje 5% <b>195.00</b> | Ulje 4% <b>191.10</b> | <b>1.5</b> |
| Puna direkte                    | € për 8 <sup>h</sup>     | 800.00        | Rritje 2.375% 819.00  | Rritje 4% 851.76      | <b>1.5</b> |
| Efikasiteti i PD                | Njësi për 8 <sup>h</sup> | 10.00         | Rritje 2.5% 10.50     | Rritje 2% 10.92       | <b>1.5</b> |
| <b>Kosto e PD për njësi</b>     |                          | <b>80.00</b>  | <b>78.00</b>          | <b>78.00</b>          | <b>1.5</b> |
| ShPP variabile                  | € për 8 <sup>h</sup>     | 600.00        | Rritje 1.5% 609.00    | Rritje 4% 633.36      | <b>1.5</b> |
| Efikasiteti i PD                | Njësi për 8 <sup>h</sup> | 10.00         | Rritje 2.5% 10.50     | Rritje 2% 10.92       | <b>1.5</b> |
| <b>ShPP variabile për njësi</b> |                          | <b>60.00</b>  | <b>58.00</b>          | <b>58.00</b>          | <b>1.5</b> |
| ShPP fikse                      |                          | 560,000       | Rritje 12.5% 655,200  | Rritje 3.5% 652,050   | <b>1.5</b> |
| Njësi (për t'u prodhuar)        |                          | 7,000         | 8,400                 | 6,750                 |            |
| <b>ShPP fikse për njësi</b>     |                          | <b>80.00</b>  | <b>75.00</b>          | <b>96.60</b>          | <b>1.5</b> |

**13.5 pikë**

Kosto total për njësi

|                               | Viti 1        | Viti 2        | Viti 3        |            |
|-------------------------------|---------------|---------------|---------------|------------|
| Njësi (për t'u prodhuar)      | 7,000         | 8,400         | 6,750         |            |
| Materialet direkte            | 200.00        | 195.00        | 191.10        |            |
| Kosto e PD për njësi          | 80.00         | 78.00         | 78.00         |            |
| ShPP variabile për njësi      | 60.00         | 58.00         | 58.00         |            |
| ShPP fikse për njësi          | 80.00         | 75.00         | 96.60         |            |
| <b>Kosto totale për njësi</b> | <b>420.00</b> | <b>406.00</b> | <b>423.70</b> | <b>1.5</b> |

**1.5 pikë**

b. Llogaritja e fitimit në vlerë monetare dhe koeficienti i fitimit:

|  | Viti 1            | Viti 2            | Viti 3            | Cikli jetësor       |            |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|---------------------|------------|
| Të hyrat për njësi   | 520.00            | 505.00            | 505.00            |                     |            |
| Kostot për njësi   | -420.00           | -406.00           | -423.70           |                     |            |
| Fitimi për njësi   | 100.00            | 99.00             | 81.30             |                     |            |
| Njësi (për t'u prodhuar)   | × 7,000           | × 8,400           | × 6,750           |                     |            |
| Fitimi i përgjithshëm  | <b>700,000.00</b> | <b>831,600.00</b> | <b>548,775.00</b> | <b>2,080,375.00</b> | <b>2.0</b> |
| Norma minimale e kthimit në fitim (fitimi ÷ të hyrat nga shitja) | <b>19.23%</b>     | <b>19.60%</b>     | <b>16.10%</b>     | <b>18.43%</b>       | <b>2.0</b> |

**4 pikë**

ose

|                                   | Viti 1         | Viti 2         | Viti 3         | Cikli jetësor    |            |
|-----------------------------------|----------------|----------------|----------------|------------------|------------|
| Të hyrat e përgjithshme           | 3,640,000      | 4,242,000      | 3,408,750      | 11,290,750       |            |
| Kostot e përgjithshme             | -2,940,000     | -3,410,400     | -2,859,975     | 9,210,375        |            |
| Fitimi i përgjithshëm             | <b>700,000</b> | <b>831,600</b> | <b>548,775</b> | <b>2,080,375</b> | <b>2.0</b> |
| Norma minimale e kthimit në fitim | <b>19.23%</b>  | <b>19.60%</b>  | <b>16.10%</b>  | <b>18.43%</b>    | <b>2.0</b> |

Norma minimale e kthimit në fitim në vitin 1 (19.23% > 17.00%) dhe në vitin 2 (19.60% > 17.00%) është më e lartë se norma e kërkuar e kthimit derisa në vitin 3 (16.10% < 17.00%) është më e ultë se norma e kërkuar e kthimit. Kërkesa e menaxhmentit lidhur me pranueshmerinë dhe miratimin e fillimit të prodhimit për produktet e reja është 17.00% **përgjatë ciklit jetësor** të produktit që në rastin e Kompanisë FIT, norma e fitim e kthimit në fitim përgjatë ciklit jetësor është 18.43% që është normë më e lartë se norma e kërkuar (18.43% > 17.00%) që e bënë të pranueshëm produktin, andaj edhe miratohet fillimi i procesit të prodhimit të produktit NRG500.

**1 pikë**

## Problemi 2

a. Bazohuni në të dhënat dhe rezultatet e arritura në Problemin 1.

Menaxhmenti i kompanisë FIT është duke shqyrtuar mundësin e aplikimit të sistemit të kostos së synuar duke filluar nga viti i ardhshëm. Një nga ndryshimet që është duke u shqyrtuar është caktimi i marzhës së synuar të fitimit prej **20% në çmimin e shitjes** në vend të normës minimale të kthimit në fitim prej 17%.

### Kërkohet:

- i. Të llogaritet marzha e synuar e fitimit për njësi (në vlerë monetare) dhe kostoja e synuar e prodhimit për njësi të produktit NRG500 për secilin vit. **3 pikë**
- ii. Të llogaritet hendeku i kostos për njësi për secilin vit, hendeku total të kostos për vëllimin respektiv për secilin vit, dhe hendekun e përgjithshëm përgjatë gjithë ciklin jetësor të produktit NRG500. **3.5 pikë**
- iii. Nëse kompania me masat e ndërmarra arrin të mbyllë me saktësi hendekun e kostove për secilin vit, të llogaritet fitimi në vlerë monetare dhe koeficienti i fitimit për **secilin vit** si dhe fitimi në vlerë monetare dhe koeficienti i fitimit përgjatë **gjithë ciklit jetësorë** të produktit NRG500. **3.5 pikë**

b. Sistemet informative lejojnë menaxherët të marrin vendime të duhura, efektive dhe në kohë të duhur duke përdorur të dhënat e përpunuara në një formë të përshtatshme.

### Kërkohet:

- i. Për tri nga katër prej sistemeve informative të listuara në vazhdim, shkurtimisht të shpjegohet roli dhe përdorimi i tyre në një organizatë:
  - Sistemet e përpunimit të transaksioneve (TPS)
  - Sistemet informative të menaxhimit (MIS)
  - Sistemet informative ekzekutive (EIS)
  - Sistemet e planifikimit të burimeve të ndërmarrjes (Sistemet ERP) **9 pikë**
- ii. Cilët janë përbërësit e domosdoshëm të një sistemi informativ? **1 pikë**

## Zgjidhja

**a.i.** Llogaritja e marzhës synuar të fitimit për njësi (në €) dhe kostoja e synuar e prodhimit:

|                 | Viti 1          | Viti 2          | Viti 3          | Gjithsej |            |
|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|----------|------------|
| Çmimi i shitjes | 520.00          | 505.00          | 505.00          |          |            |
| Norma e fitimit | × 20%           | × 20%           | × 20%           |          |            |
| Fitimi i synuar | <b>- 104.00</b> | <b>- 101.00</b> | <b>- 101.00</b> |          | <b>1.5</b> |
| Kosto e synuar  | <b>416.00</b>   | <b>404.00</b>   | <b>404.00</b>   |          | <b>1.5</b> |

**3 pikë**

**a.ii.** Llogaritja e hendekut të kostos për njësi për secilin vit, hendeku total të kostos për vëllimin respektiv për secilin vit, dhe hendekun e përgjithshëm përgjatë gjithë ciklin jetësor

|                                 |                 |                 |                  |                  |            |
|---------------------------------|-----------------|-----------------|------------------|------------------|------------|
| Kosto e synuar                  | 416.00          | 404.00          | 404.00           |                  |            |
| Kosto e vlerësuar               | <b>- 420.00</b> | <b>- 406.00</b> | <b>- 423.70</b>  |                  |            |
| Hendeku i kostos                | <b>- 4.00</b>   | <b>- 2.00</b>   | <b>- 19.70</b>   |                  | <b>1.5</b> |
| Njësi (për t'u prodhuar)        | 7,000           | 8,400           | 6,750            |                  |            |
| Hendeku i përgjithshëm i kostos | <b>- 28,000</b> | <b>- 16,800</b> | <b>- 132,975</b> | <b>- 177,775</b> | <b>2.0</b> |

**3.5 pikë**

**a.iii.** Llogaritja e fitimit në vlerë monetare dhe koeficienti i fitimit për secilin vit si dhe fitimi në vlerë monetare dhe koeficienti i fitimit përgjatë gjithë ciklit jetësorë nëse mbyllet me saktësi hendeku i kostos:

|                         |                    |                    |                    |                  |            |
|-------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|------------------|------------|
| Të hyrat e përgjithshme | 3,640,000          | 4,242,000          | 3,408,750          | 11,290,750       | <b>1.0</b> |
| Kostot e përgjithshme   | <b>- 2,912,000</b> | <b>- 3,393,600</b> | <b>- 2,727,000</b> | <b>9,032,600</b> | <b>1.0</b> |
| Fitimi i përgjithshëm   | <b>728,000</b>     | <b>848,400</b>     | <b>681,750</b>     | <b>2,258,150</b> | <b>1.0</b> |
| Koeficienti i fitimit   | <b>20.00%</b>      | <b>20.00%</b>      | <b>20.00%</b>      | <b>20.00%</b>    | <b>0.5</b> |

**3.5 pikë**

ose

|                       |                 |                 |                 |                |            |
|-----------------------|-----------------|-----------------|-----------------|----------------|------------|
| Çmimi i shitjes       | 520.00          | 505.00          | 505.00          | 1,530          | <b>1.0</b> |
| Kosto e synuar        | <b>- 416.00</b> | <b>- 404.00</b> | <b>- 404.00</b> | <b>- 1,224</b> | <b>1.0</b> |
| Fitimi për njësi      | <b>104.00</b>   | <b>101.00</b>   | <b>101.00</b>   | <b>306</b>     | <b>1.0</b> |
| Koeficienti i fitimit | <b>20.00%</b>   | <b>20.00%</b>   | <b>20.00%</b>   | <b>20.00%</b>  | <b>0.5</b> |

**b.i.** Roli dhe përdorimi i sistemeve informative në organizatë:

1. Sistemet e përpunimit të transaksioneve (TPS)

- Sistemet e përpunimit të transaksionit (TPS) mbledhin, deponojnë / ruajnë, modifikojnë dhe rikthejnë transaksionet e një organizate.
- *Përpunimi i transaksioneve në grup* (Batch Transaction Processing - BTP) mbledh të dhënat e transaksioneve në grup dhe i përpunon më vonë, pas një kohe, si grup i të dhënave të njëjta, p.sh. kontrollimi i çqeve.
- *Përpunimi i transaksionit në kohë reale* (Real Time Transaction Processing - RTTP) është përpunimi i menjëhershëm i të dhënave. Kjo përfshin përdorimin e një terminali apo sporteli për të futë të dhënat dhe të shfaqë rezultatet dhe siguron konfirmim të menjëhershëm. Një numër i madh i përdoruesve mund të kryejnë transaksione në të njëjtën kohë, por është e nevojshme qasja në bazën qendrore të të dhënave, p.sh. përdoren për rezervime të fluturimit, trenit dhe hotelit dhe kërkojnë afat të pranueshëm për përgjigje derisa

transaksionet kryhen në prani të konsumatorëve, bërja e rezervimeve që përfshinë vendosjen mënjane të një shërbimi apo produkti që konsumatorët ta përdorin në të ardhmen, etj.

2. Sistemet informative të menaxhimit (MIS)

- *Sistemet informative të menaxhimit - SIM* (Management Information Systems - MIS) nxjerrin, përpunojnë dhe përmbledhin të dhënat nga TPS-të dhe sigurojnë raporte periodike (javore, mujore, tremujore) për menaxherët.
- *Sistemet informative të menaxhimit - SIM përdorën* dhe ju mundësojnë menaxherëve të marrin vendime efektive dhe me kohë, për planifikim, drejtim dhe kontroll të aktiviteteve për të cilat janë përgjegjës

3. Sistemet informative ekzekutive (EIS)

- *Sistemet informative ekzekutive - SIE* (Executive Information Systems - EIS) nxjerrin të dhënat nga SIM dhe lejon komunikimin me burimet e jashtme të të dhënave.
- *Sistemet informative ekzekutive – SIE, përdorën* për nxjerrjen e të dhënave nga SIM për të ju lejuar të bëhet komunikimi me burimet e jashtme të të dhënave. Për një përdorim të tillë sistemet informative ekzekutive – SIE janë të dizajnuara për të lehtësuar qasjen e menaxherëve të lartë në informata në mënyrë të shpejt dhe efektive.

4. Sistemet e planifikimit të burimeve të ndërmarrjes (Sistemet ERP)

- *Sistemet e planifikimit të burimeve të ndërmarrjes (Sistemet ERP)* - janë paketa modulare softuerike të projektuara për të integruar proceset kyçe të një organizate në mënyrë që një sistem i vetëm të mund t'i shërbejë nevojave për të dhënat e të gjitha fushave funksionale
- *Sistemet ERP përdorën* në planifikimin dhe shpërndarjen e të gjitha llojeve të burimeve, fizike, monetare dhe njerëzore, p.sh. kompania e ujit mund të përdorë sistemin e tyre ERP për të caktuar një punë riparimi, të caktojë riparuesin për punë, të verifikojë se puna është bërë, dhe më pas të faturoj konsumatorin etj.

**(3 × 3 pikë) max. 9 pikë**

**b.ii.** Përbërësit e domosdoshëm të një sistemi informativ:

Përbërësit e TPS-së përfshijnë:

- harduerin,
- softuerin dhe
- njerëzit,

**1 pikë**

- *Përdoruesit* janë punonjësit e kompanisë që zotërojnë TPS-in. Përdoruesit nuk do të ndryshojnë të dhënat vetë, por do të përdorin TPS që të ofrojnë të dhëna/input - e për sisteme tjera informative, të tillë si kontrolli i stokeve.
- *Pjesëmarrësit* janë përdoruesit e drejtpërdrejtë të sistemit. Ata janë njerëz që fusin të dhënat. Pjesëmarrësit përfshijnë operatorët për futjen e të dhënave, stafin e shërbimit të klientit dhe njerëzit që punojnë në pikat kontrolluese të daljes.
- *Njerëzit nga mjedisi* janë njerëz që nganjëherë kërkojnë shërbimet e TPS pasi ata fusin transaksionet dhe vërtetojnë të dhënat, siç janë klientët që tërheqin para nga ATM



### Problemi 3

ABC Co prodhon dy produkte, A dhe B. Të dy produktet kalojnë përmes dy proceseve të prodhimit, procesit të farkimit dhe atij të dhënies së formës.

Produkti A shitet €230, ndërsa produkti B shitet me çmim prej \$350. Përgjatë javës kërkesa për produktin A është e pakufizuar ndërsa për produktin B kërkesa është e kufizuar në 10 njësi. Orët e punës në dispozicion për procesin e farkimit të kufizuara në 420 orë brenda javës ndërsa për procesin e dhënies së formës gjatë javës janë në dispozicion vetëm 180 orë. Të dhënat tjera relevante janë si më poshtë.

|                           | <u>Procesi i farkimit</u> | <u>Procesi i dhënies së formës</u> |
|---------------------------|---------------------------|------------------------------------|
| Produkti A                | 12 orë                    | 6 orë                              |
| Produkti B                | 18 orë                    | 4 orë                              |
| Kosto variabile për njësi |                           |                                    |
| Produkti A                | €150                      |                                    |
| Produkti B                | €260                      |                                    |

Bazuar në përvojat e deritanishme është vetëtuar se kontributi maksimal gjatë javës arrihet kur shiten 26 njësi të produktit A dhe 6 njësi të Produktit B. Qëllimi i organizatës është maksimizimi i kontributit.

#### **Kërkohet:**

- Të llogaritet vlera e kontributit maksimal (funktionit objektiv) që Kompania ABC mund të realizoi gjatë një jave, bazuar në numrin e njësisve të Produkteve A dhe B që duhet të shiten bazuar në përvojat e deritanishme për maksimizimin e kontributit. **1 pikë**
- Kur ndodhë dhe çfarë është mos-shfrytëzimi i burimit apo faktorit kufizues? Kur ndodhë dhe çfarë është mbi-shfrytëzimi i burimit apo faktorit kufizues? **2 pikë**
- Të llogaritet mos-/mbi-shfrytëzimi për secilin prej burimeve apo faktorëve kufizues (orëve të punës në procesin e farkimit, orëve të punës në procesin e dhënies së formës dhe kërkesës). **6.5 pikë**
- Çfarë është çmimi hije (çmimi dual)? Të llogaritet çmimi hije për secilin prej burimeve apo faktorëve kufizues (orëve të punës në procesin e farkimit, orëve të punës në procesin e dhënies së formës dhe kërkesës). **10.5 pikë**

## Zgjidhja

- a. Llogaritja e kontributit maksimal bazuar në prodhimin dhe shitjen e 26 Produkte A dhe 6 Produkte B.

$$\text{Kontributi}_{(\max)} = 80A + 90B$$

Ku, A= 26 Produkte A dhe

B= 6 Produkte B

$$\begin{aligned}\text{Kontributi}_{(\max)} &= (\text{€}80 \times 26) + (\text{€}90 \times 6) \\ &= \text{€}2,080 + \text{€}540 \\ &= \text{€}2,620.00\end{aligned}$$

**1 pikë**

- b. Mos-shfrytëzimi ndodh kur disponueshmëria maksimale e një burimi apo faktori tjetër kufizues nuk është përdorur.

- mos-shfrytëzimi është shuma të papërdorur e burimit ose kufizim tjetër, ku kufizimi është 'më i vogël ose e barabartë me' kufizimin. **1 pikë**

Mbi-shfrytëzimi (teprica) ndodh kur një burim apo faktor tjetër kufizues është përdorur më shumë se minimumi i nevojshëm.

- mbi-shfrytëzimi është tejkalimi i shfrytëzimit të burimit apo faktorit tjetër kufizues mbi sasinë minimale të kufizimit, ku kufizimi është 'më i madh ose e barabartë me' kufizimin. **1 pikë**

- c. Llogaritja e mos-/mbi-shfrytëzimit të secilit burim apo faktori kufizues

- orët e punës në procesin e farkimit:

$$\text{Disponueshmëria} = 420 \text{ orë}$$

$$\begin{aligned}\text{Shfrytëzimi:} & (26 \text{ njësi} \times 12 \text{ orë}) + (6 \text{ njësi} \times 18 \text{ orë}) \\ & (312 \text{ orë} + 108 \text{ orë}) \\ & \mathbf{420 \text{ orë}}\end{aligned}$$

**Disponueshmëria = Shfrytëzimin**

Nuk ka mos-/mbi-shfrytëzim. Kufizimi është lidhës.

**2 pikë**

- Puna  $\text{Disponueshmëria} = 180 \text{ orë}$   
 $\text{Shfrytëzimi:} (26 \text{ njësi} \times 6 \text{ orë}) + (6 \text{ njësi} \times 4 \text{ orë})$   
 $(156 \text{ orë} + 24 \text{ orë})$   
**180 orë**  
**Disponueshmëria = Shfrytëzimin**

Nuk ka mos-/mbi-shfrytëzim. Kufizimi është lidhës.

**2 pikë**

- Kërkesa për Produktin A Nuk ka kufizim

**0.5 pikë**

- Kërkesa për Produktin B 10 njësi

$$\begin{aligned}\text{Kontributi}_{(\max)} \text{ arrihet me } & 6 \text{ njësi} \\ & 10 \text{ njësi} - 6 \text{ njësi} \\ & 4 \text{ njësi}\end{aligned}$$

**Mos-shfrytëzimi i kërkesës për figura të elefantit 4 njësi**

**2 pikë**

- d. Çmimi hije (çmimi dual) i një faktori kufizues është shuma e ndryshimit në vlerën e funksionit objektiv (për shembull, rritja e kontributit), e krijuar nga disponueshmëria e një njësie shtesë të burimit kufizues me koston e tij fillestare **2 pikë**

Nëse kemi në dispozicion **1 orë** me shumë të kohës së punës në procesit të farkimit atëherë kufizimi do të jetë:

$$12A + 18B = 421$$

Kontributi maksimal:

$$12A + 18B = 421 \quad (1)$$

$$6A + 4B = 180 \quad (2)$$

$$(2) \times 2 \quad 12A + 18B = 421 \quad (1)$$

$$\underline{12A + 8B = 360} \quad (2a)$$

$$(1) - (2a) \quad 10B = 61$$

$$\mathbf{B = 61 \div 10 = 6.10} \quad \mathbf{1 \text{ pikë}}$$

Nëse zëvendësojmë B = 6.10 në ekuacionin (1) atëherë:

$$12A + (18 \times 6.10) = 421$$

$$12A = 421 - 109.80$$

$$12A = 311.20$$

$$\mathbf{A = 311.20 \div 12 = 25.93} \quad \mathbf{1 \text{ pikë}}$$

$$\text{Kontributi}_{(\max)} = 80A + 90B$$

$$= (80 \times 25.93) + (90 \times 6.10)$$

$$= 2,074.67 + 549.00$$

$$\mathbf{Kontributi}_{(\max)} = \mathbf{2,623.67} \quad \mathbf{1 \text{ pikë}}$$

Nëse kemi në dispozicion **1 orë** me shumë të kohës së punës në procesin e dhënies së formës atëherë kufizimi do të jetë:

$$6A + 4B = 181$$

Kontributi maksimal:

$$12A + 18B = 420 \quad (1)$$

$$6A + 4B = 181 \quad (2)$$

$$(2) \times 2 \quad 12A + 18B = 420 \quad (1)$$

$$\underline{12A + 8B = 362} \quad (2b)$$

$$(1) - (2b) \quad 10B = 58$$

$$\mathbf{B = 58 \div 10 = 5.8} \quad \mathbf{1 \text{ pikë}}$$

Nëse zëvendësojmë B = 5.8 në ekuacionin (1) atëherë:

$$12A + (18 \times 5.8) = 420$$

$$12A = 420 - 104.40$$

$$12A = 315.60$$

$$\mathbf{A = 315.60 \div 12 = 26.30} \quad \mathbf{1 \text{ pikë}}$$

$$\begin{aligned}
 \text{Kontributi}_{(\max)} &= 80A + 90B \\
 &= (80 \times 26.30) + (90 \times 5.80) \\
 &= 2,104 + 522
 \end{aligned}$$

$$\text{Kontributi}_{(\max)} = 2,626$$

**1 pikë**

Çmimi hije i orës shtesë të punës në procesin e farkimit:

Kontributi me 1 orë shtesë të punës në procesin e farkimit 2,623.67

Kontributi bazë 2,620.00

**Çmimi hije** i orës shtesë të punës në procesin e farkimit **3.67**

**1 pikë**

Çmimi hije i orës shtesë të punës në procesin e dhënies së formës:

Kontributi me 1 orë shtesë të punës në procesin e dhënies së formës 2,626.00

Kontributi bazë 2,620.00

**Çmimi hije** i orës shtesë të punës në procesin e dhënies së formës **6.00**

**1 pikë**

Çmimi hije i kërkesës për Produktin A është 0, sepse aty kemi mos-shfrytëzim të kërkesës.

**0.5 pikë**

#### Problemi 4

- a. Kompania Topi është një biznes familjar që merret me prodhimin e topave të futbollit. Punonjësit e kompanisë punojnë 5 ditë në javë nga 8 orë. Kompania ka një kapacitet prodhues vjetor prej 200,000 njësi. Të dhënat për tremujorin 4 të vitit të kaluar dhe tremujorët 1 dhe 2 të vitit aktual lidhur me prodhimtarinë dhe kostot respektive të prodhimtarisë janë dhënë në vazhdim:

|       | Viti i kaluar | Viti aktual |             |
|-------|---------------|-------------|-------------|
|       | Tremujori 4   | Tremujori 1 | Tremujori 2 |
| Njësi | 25,000        | 30,000      | 35,000      |
| MD    | 112,500       | 135,000     | 157,500     |
| PD    | 97,500        | 117,000     | 136,500     |
| ShPP  | 162,500       | 174,000     | 185,500     |

Meqenëse ky vit është viti kur zhvillohet kampionati Evropian i futbollit, pronari i kompanisë shpreson se kjo ngjarje e madhe sportive do të ndikoi në rritjen e popullaritetit të futbollit dhe kërkesën për topa të futbollit andaj për tremujorin 3 të këtij viti ka buxhetuar të prodhon 50,000 topa me dizajn të ngjashëm me topat që luhet në kampionat.

#### Kërkohet:

Pronari i kompanisë kërkon nga ju që të llogaritni koston totale dhe koston për njësi që do të shkaktohet si dhe të hyrat që do të gjenerohen në tremujorin 3 të këtij viti për nivelin e buxhetuar të prodhimtarisë. Kompania llogaritë marzhën 20% në çmimin e shitjes. **10 pikë**

- b. Njëra nga kompetencat që kërkohet nga ju për të përmbushur njërën nga objektivat e performancës është aftësia për të përgatitur buxhetet e detajuara në një nivel të duhur bazuar në të dhënat më të mira. Në rastet kur nuk është e mundur të përcaktohet koha standarde e prodhimit të produktit për shkak se secila njësi pasuese prodhohet për kohë më të shkurtër se njësia paraprake ka vështirësi në përcaktimin e koston standarde të punës rrjedhimisht edhe në përgatitjen e buxhetit. Për këto situata themi se aplikohet efekti i lakores së të mësuarit respektivisht Teoria e lakores së të mësuarit.

#### Kërkohet:

- i. Përkufizoni termet 'Norma e të mësuarit', dhe 'Efekti i të mësuarit'. **4 pikë**
- ii. Tregoni së paku dy situata ku aplikohet 'Lakorja e të mësuarit' **2 pikë**
- iii. Listoni së paku katër kufizime të lakores së të mësuarit. **4 pikë**

## Zgjidhja

### a. Metoda 'e lartë – e ultë'

#### Hapi 1

- Niveli i lartë i aktiviteteve **Tremujori 2 – viti aktual**
- Niveli i ultë i aktiviteteve **Tremujori 4 – viti paraprak** **1 pikë**

#### Hapi 2

| <u>Periudha</u>             | <u>Kostot</u>   | <u>Aktiviteti</u>   |               |
|-----------------------------|-----------------|---------------------|---------------|
| Tremujori 2 – viti aktual   | <b>€185,500</b> | <b>35,000</b> njësi |               |
| Tremujori 4 – viti paraprak | <b>€162,500</b> | <b>25,000</b> njësi | <b>1 pikë</b> |

#### Hapi 3 - Përcaktimi i koston variable për njësi

$$\begin{aligned} \text{Kosto variable për njësi} &= (\text{€}192,500 - \text{€}162,500) \div (35,000 - 25,000) \\ &= \text{€}23,000 \div 3,000 \text{ njësi} \\ &= \text{€}2.30 \text{ për njësi} \end{aligned} \quad \mathbf{1 \text{ pikë}}$$

#### Hapi 4 - Përcaktimi i koston së përgjithshme fikse

$$\begin{aligned} \text{Kosto e përgjithshme fikse} &= \text{Kosto totale} - (\text{kosto variable për njësi} \times \text{numri i njësive}) \\ &= \text{€}185,500 - (\text{€}2.30 \times 35,000) \\ &= \text{€}185,500 - \text{€}80,500 \\ &= \text{€}105,000 \end{aligned} \quad \mathbf{1.5 \text{ pikë}}$$

#### Llogaritja e koston totale dhe koston për njësi për prodhimin e 50,000 njësive

|                                       |        |      |                |               |
|---------------------------------------|--------|------|----------------|---------------|
| Materialet direkte                    | 50,000 | 4.50 | 225,000        |               |
| Puna direkte                          | 50,000 | 3.90 | 195,000        |               |
| ShPP variable                         | 50,000 | 2.30 | 115,000        |               |
| ShPP fikse                            |        |      | <u>105,000</u> |               |
| <b>Kostot totale për 50,000 njësi</b> |        |      | <b>640,000</b> | <b>1 pikë</b> |
| Numri i njësive                       |        |      | $\div 50,000$  |               |
| <b>Kosto totale për njësi</b>         |        |      | <b>12.80</b>   | <b>1 pikë</b> |

#### Llogaritja e të hyrave totale

$$\text{Të hyrat totale} = \text{Çmimi i shitjes} \times \text{Numri i njësive}$$

$$\text{Çmimi i shitjes} = ?$$

$$\text{Numri i njësive} = 50,000$$

#### Llogaritje e çmimit të shitjes

$$\text{Marzha e fitimit prej } 20\% \text{ në çmimin e shitjes} = \text{marzha e fitimit prej } 25\% \text{ mbi koston e plotë}$$

$$(100 \times 20) \div (100 - 20) = 2,000 \div 80 = 25\% \quad \mathbf{1 \text{ pikë}}$$

$$\text{Çmimi i shitjes} = \text{Kosto e plotë} + (\text{kosto e plotë} \times \text{marzha e fitimit mbi koston e plotë})$$

$$= \text{€}12.80 + (\text{€}12.80 \times 25\%)$$

$$= \text{€}12.80 + \text{€}3.20$$

$$= \text{€}16.00 \quad \mathbf{1.5 \text{ pikë}}$$

$$\text{Të hyrat totale} = \text{Çmimi i shitjes} \times \text{Numri i njësive}$$

$$= \text{€}16.00 \times 50,000$$

$$= \text{€}800,000 \quad \mathbf{1 \text{ pikë}}$$

**b.i.** Përkufizimi i termave ‘Norma e të mësuarit’, dhe ‘Efekti i të mësuarit’:

- Norma e të mësuarit është vlera në përqindje, që aplikohet në situatat ku fuqia punëtore në përgjithësi përmirësohet sa i përket efikasitet duke u bazuar në përvojë, p.sh. norma e të mësuarit prej 80% **2 pikë**
- Efekti i të mësuarit apo efekti i lakores së të mësuarit përshkruan përshpejtimin e punës me një performancë të përsëritur. Efekti i të mësuarit është rasti, kur fuqia punëtore ka mësuar nga përvoja se si të bëhet produkti i ri, dhe ka një reduktim të madh në kohë për të bërë njësitë shtesë të produkteve të tillë. **2 pikë**

**b.ii.** Situatat ku aplikohet ‘Lakorja e të mësuarit’ – dy prej tyre:

- Lakorja e të mësuarit aplikohet në situatat kur:
  - produktet janë të bëra zakonisht nga përpjekjet e fuqisë punëtore,
  - ku aftësia e fuqisë punëtore është një faktor i rëndësishëm në procesin e prodhimit,
  - kur produkti është i ri apo ka jetë relativisht të shkurtër,
  - kur produktet janë komplekse dhe të bëra në sasi të vogla me porosi të veçanta.**max. 2 pikë**

**b.iii.** Kufizimet e lakores së të mësuarit – katër prej tyre:

- Kufizimet e lakores së të mësuarit:
  - Fenomeni i lakores së të mësuarit nuk është gjithmonë i pranishëm,
  - supozon kushte të qëndrueshme në punë e cila do të mundësojë që të mësuarit të ndodhë, kjo nuk është gjithmonë lehtë të bëhet në praktikë, p.sh. për shkak të ‘qarkullimit’ të punëtorëve,
  - supozon një nivel të caktuar të motivimit mes punëtorëve,
  - ndalesat në procesin e prodhimitarisë së përsëritshme të një artikulli nuk duhet të jenë shumë të gjata, sepse punëtorët do të ‘harrojnë’ dhe procesi i të mësuarit do të fillojë përsëri,
  - mund të jetë vështirë për të nxjerrë të dhëna të sakta për të vendosur se cila është lakorja e të mësuarit,
  - teknikat e prodhimit mund të ndryshojnë, apo ndryshimet në dizajnin e produktit mund të ndodhin, kështu që kjo mund të merr kohë të gjatë që një metodë e prodhimit ‘standard’ të arrihet, për të cilin një efekt mësimi do të aplikohet.
  - për qëllime të planifikimit dhe të kontrollit, menaxhmenti i prodhimitarisë dhe punëtorët mund të rezistojnë përpjekjeve për të planifikuar zvogëlimin e kohës mesatare të prodhimitarisë, sepse kjo do të sjellë ata nën presion për të arritur reduktimet e pritshme të kohës,
  - punonjësit mund të kërkojnë një formë të bonuseve si shpërblim për arritjen e reduktimeve të kohës etj. **max. 4 pikë**

### Problemi 5

Në fund të vitit të parë të operimit të Kompanisë 'Darda', menaxheri financiar ka përgatitur Raportin e rezultateve financiare dhe i ka prezantuar ato Bordit të Aksionarëve. Pas prezantimit të këtij raporti, kryetari i Bordit të Aksionarëve kërkoi të dinte nëse performanca e treguar është e kënaqshme.

Menaxheri financiar ju caktoi juve që ta bëni këtë matje të performancës. Me mësimet e marra në SCAAK ju jeni në dijeni se duke përdorur të dhënat nga pasqyrat financiare mund të bëhet matja e performancës përmes treguesve financiar, tregues të cilët duhet të krahasohen kundrejt performancës të viteve paraprake, konkurrentëve apo mesatares së industrisë të cilës i përket biznesi, për të përcaktuar nëse dhe ku performanca është e kënaqshme apo jo.

Meqenëse ky ishte viti i parë i aktivitetit të kompanisë, nuk kishte të dhëna financiare të mëhershme për të bërë krahasueshmëri me vitet paraprake. Pas hulumtimit të zhvilluar konstatuat se edhe nga Agjencia vendore e Statistikave apo Odat ekonomike të vendit nuk kishte të dhëna të tilla.

Më në fund duke hulumtuar bizneset individuale të industrisë së ngjashme i gjetët pasqyrat financiare të kompanisë të një vendi të regjionit e cila në masë të konsiderueshme eksporton në vendin tonë, ndaj edhe mund të konsiderohet si konkurrenti i Kompanisë.

Zëra të përzgjedhur të pasqyrave financiare dhe informata nga shënimet shpjeguese të Kompanisë 'Darda' dhe kompanisë konkurrenente janë paraqitur në vazhdim:

|  | <u>Kompania</u><br><u>'Darda'</u> |       | <u>Kompania</u><br><u>konkurrenente</u> |       |
|--|-----------------------------------|-------|---|-------|
|  | € .000                            |       | € .000                                  |       |
| Të hyrat nga shitja  |                                   | 2,270 |   | 2,320 |
| Kosto e mallit të shitur (KMSH)                            |                                   | 1,690 |   | 1,590 |
| Kosto variabile e shitjes                                  |                                   | 1,250 |   | 1,220 |
| Fitimi operativ (Fitimi Para Interesit dhe Tatimit - FPIT) |                                   | 420   |   | 500   |
| Kapitali i angazhuar (pasuria – detyrimet afat-shkurtra)   |                                   | 2,120 |   | 2,250 |
| Shpenzimet e interesit                                     |                                   | 60    |   | 100   |
| Shpenzimet e tatimit                                       |                                   | 110   |   | 130   |
| Pasuritë themelore (vlera neto)                            |                                   | 1,750 |   | 1,790 |
| Stoqet   |                                   | 360   |   | 410   |
| Llogaritë e arkëtueshme (LL/A)                             |                                   | 550   |   | 520   |
| Paratë e gatshme   |                                   | 140   |   | 150   |
| Detyrimet afatshkurtra                                     |                                   | 680   |   | 620   |
| Llogaritë e pagueshme (LL/P)                               |                                   | 420   |   | 430   |
| Kreditë afatgjata  |                                   | 800   |   | 560   |
| Aksionet e zakonshme                                       | 1,000 × €1                        | 1,000 | 1,200 × €1                              | 1,200 |
| Aksionet preferenciale me 10% (për dy kompanitë)           | €320                              |       | €490                                    |       |

### Kërkohet:

a. Të llogariten treguesit e mëposhtëm financiar të performancës:

i. Treguesit e profitabilitetit (parësor dhe dytësor)

- Koeficienti i fitimit bruto
- Koeficienti i kontributit
- Koeficienti i fitimit neto
- Koeficienti i fitimit për aksion

**7 pikë**



- Koeficienti ROCE (kthimit në kapitalin e angazhuar)
  - Koeficienti i qarkullimit të pasurisë
  - Koeficienti i kthimit në ekuitet
- ii. Treguesit e levës **2 pikë**
- Koeficienti i levës financiare
  - Koeficienti i levës operative
- iii. Treguesit e likuiditetit dhe rrjedhjes së parasë **5 pikë**
- Koeficienti aktual (qarkullues)
  - Koeficienti i shpejtë (Acid-test)
  - Ditët e llogarive të arkëtueshme (Periudha e arkëtimit të LI/A)
  - Ditët e llogarive të pagueshme (Periudha e pagesës së LI/P)
  - Ditët e stoqeve
- b. Përgatiteni raportin për Bordin e aksionarëve për rezultatet e analizës **6 pikë**

## Zgjidhja

### a.i. Treguesit e profitabilitetit (parësor dhe dytësor)

- Koeficienti i fitimit bruto =  $(\text{Shitjet} - \text{KMSH}) \div \text{Shitjet} = \text{Fitim bruto} \div \text{Shitjet}$ 
  - Kompania 'Darda'  $(2,270 - 1,690) \div 2,270 = 580 \div 2,270 = 25.55\%$  **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(2,320 - 1,590) \div 2,320 = 730 \div 2,320 = 31.47\%$  **0.5 pikë**
  
- Koeficienti i kontributit =  $(\text{Shitjet} - \text{Kostot e shitjes (variabile)}) \div \text{Shitjet} = \text{kontributi} \div \text{Shitjet}$ 
  - Kompania 'Darda'  $(2,270 - 1,250) \div 2,270 = 1,020 \div 2,270 = 44.93\%$  **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(2,320 - 1,220) \div 2,320 = 1,100 \div 2,320 = 47.41\%$  **0.5 pikë**
  
- Koeficienti i fitimit neto =  $\text{Fitimi neto} \div \text{Shitjet}$ 
  - Kompania 'Darda'  $(420 - 60 - 110) \div 2,270 = 250 \div 2,270 = 11.01\%$  **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(500 - 100 - 130) \div 2,320 = 270 \div 2,320 = 11.64\%$  **0.5 pikë**
  
- Koeficienti i fitimit për aksion =  $\text{Fitimi pas tatimit dhe çfarëdo dividendi preferencial} \div \text{numri i aksioneve të emetuara}$ 
  - Kompania 'Darda'  $[(420 - 60 - 110) - (320 \times 10\%)] \div 1,000 = (250 - 32) \div 1,000 = 0.25$  **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $[(500 - 100 - 130) - (490 \times 10\%)] \div 1,200 = (270 - 49) \div 1,200 = 0.27$  **0.5 pikë**
  
- Koeficienti ROCE (kthimit në kapitalin e angazhuar) =  $\text{FPIT} \div \text{Kapitali i angazhuar}$ 
  - Kompania 'Darda'  $420 \div 2,120 = 19.81\%$  **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $500 \div 2,250 = 22.22\%$  **0.5 pikë**
  
- Koeficienti i qarkullimit të pasurisë =  $\text{Shitjet} \div \text{Kapitali i angazhuar}$ 
  - Kompania 'Darda'  $2,270 \div 2,120 = 1.07$  herë **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $2,230 \div 2,250 = 1.03$  herë **0.5 pikë**
  
- Koeficienti i kthimit në ekuitet =  $\text{Fitimi neto} \div \text{Ekuiteti}$ 
  - Kompania 'Darda'  $(420 - 60 - 110) \div (1,750 + 360 + 550 + 140 - 680 - 800)^* = 250 \div 1,320 = 18.94\%$  **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(500 - 100 - 130) \div (1,790 + 410 + 520 + 150 - 620 - 560)^* = 270 \div 1,690 = 15.98\%$  **0.5 pikë**

\* Ekuiteti (kompania 'Darda') =  $1,750 + 360 + 550 + 140 - 680 - 800 = 1,320$

\* Ekuiteti (kompania konkurruese) =  $1,790 + 410 + 520 + 150 - 620 - 560 = 1,690$

### a.ii. Treguesit e levës

- Koeficienti i levës financiare =  $\text{Borxhi} \div (\text{Borxhi} + \text{Ekuiteti})$  ose  $\text{Borxhi} \div \text{Ekuiteti}$ 
  - Kompania 'Darda'  $800 \div (800 + 1,320) = 800 \div 2,120 = 0.38$  herëose  $800 \div 1,320 = 0.61$  herë **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $560 \div (560 + 1,690) = 560 \div 2,250 = 0.25$  herëose  $560 \div 1,690 = 0.33$  herë **0.5 pikë**

- Koeficienti i levës operative = Kontributi ÷ FPIT
  - Kompania 'Darda'  $(2,270 - 1,250) \div 420 = 1,020 \div 420 = \mathbf{2.43}$  herë **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(2,320 - 1,220) \div 500 = 1,100 \div 500 = \mathbf{2.20}$  herë **0.5 pikë**

**a.iii. Treguesit e likuiditetit dhe rrjedhjes së parasë**

- Koeficienti aktual (qarkullues) = Pasuria afat-shkurtër (PASH) ÷ Detyrimet afat-shkurtër (DASH)
  - Kompania 'Darda'  $(360 + 550 + 140) \div 680 = 1,050 \div 680 = \mathbf{1.54}$  **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(410 + 520 + 150) \div 620 = 1,080 \div 620 = \mathbf{1.74}$  **0.5 pikë**
  
- Koeficienti i shpejtë (Acid-test) = (PASH - Stoqet) ÷ DASH
  - Kompania 'Darda'  $(550 + 140) \div 680 = 690 \div 680 = \mathbf{1.01}$  **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(520 + 150) \div 620 = 670 \div 620 = \mathbf{1.08}$  **0.5 pikë**
  
- Ditët e llogarive të arkëtueshme (Periudha e arkëtimit të LI/A) = (Llogaritë e arkëtueshme tregtare ÷ Qarkullimi i shitjeve me kredi afat-shkurtra) x 365
  - Kompania 'Darda'  $(550 \div 2,270) \times 365 = \mathbf{88.84}$  ditë **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(520 \div 2,320) \times 365 = \mathbf{81.81}$  ditë **0.5 pikë**
  
- Ditët e llogarive të pagueshme (Periudha e pagesës së LI/P) = (Mesatarja e LL/P tregtare ÷ Blerjet me kredi ose Kosto e shitjes) x 365
  - Kompania 'Darda'  $(420 \div 1,690) \times 365 = \mathbf{90.71}$  ditë **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(430 \div 1,590) \times 365 = \mathbf{98.71}$  ditë **0.5 pikë**
  
- Ditët e stoqeve = (Stoqet ÷ Kosto e shitjes) x 365
  - Kompania 'Darda'  $(360 \div 1,690) \times 365 = \mathbf{77.75}$  ditë **0.5 pikë**
  - Kompania konkurruese  $(410 \div 1,590) \times 365 = \mathbf{94.12}$  ditë **0.5 pikë**

**b. Raporti për Bordin e aksionarëve**

**RAPORT**

- Për:** Bordin e Aksionarëve **0.5 pikë**
- Nga:** Menaxheri Financiar ose Kontabilisti menaxherial **0.5 pikë**
- Data:** dita/muaji/viti **0.5 pikë**
- Lënda:** Performanca e Kompanisë në vitin e parë të aktiviteteve **0.5 pikë**

**për elementet e raportit max. 2.0 pikë**

Të nderuar/a anëtarë/e të Bordit të Aksionarëve,

Ky raport ofron një analizë të performancës së kompanisë sonë në vitin e parë të aktivitetit duke krahasuar treguesit kryesor të performancës financiare kundrejt konkurrentit tonë kryesor. Analiza përfshin krahasueshmerinë e treguesve financiar përmes treguesve parësor dhe dytësor të profitabilitetit përfshirë treguesit e 'fitimit për aksion', treguesve të levës, treguesve të likuiditetit dhe rrjedhjes së parasë (efikasitetit).

**Hyrja e raportit 1 pikë**

Në tabelën e mëposhtme janë radhitur treguesit e performancës për dy kompanitë duke i shënuar me ‘✓’ treguesit më të mirë të njëjës kompani krahasuar me kompaninë tjetër:

|   | <u>Kompania</u><br><u>'Darda'</u> |   | <u>Kompania</u><br><u>konkurruese</u> |   |
|---|-----------------------------------|---|---------------------------------------|---|
| <i>Treguesit e profitabilitetit</i>                     |                                   |   |                                       |   |
| Koeficienti i fitimit bruto                             | 25.55%                            |   | 31.47%                                | ✓ |
| Koeficienti i kontributit                               | 44.93%                            |   | 47.41%                                | ✓ |
| Koeficienti i fitimit neto                              | 11.01%                            |   | 11.64%                                | ✓ |
| Koeficienti i fitimit për aksion                        | 0.25                              |   | 0.27                                  | ✓ |
| Koeficienti ROCE  | 19.81%                            |   | 22.22%                                | ✓ |
| Koeficienti i qarkullimit të pasurisë                   | 1.07                              | ✓ | 1.03                                  |   |
| Koeficienti i kthimit në ekuitet                        | 18.94%                            | ✓ | 15.98%                                |   |
| <i>Treguesit e levës</i>                                |                                   |   |                                       |   |
| Koeficienti i levës financiare                          | 0.38                              | ✓ | 0.25                                  |   |
|   | 0.61                              | ✓ | 0.33                                  |   |
| Koeficienti i levës operative                           | 2.43                              | ✓ | 2.20                                  |   |
| <i>Treguesit e likuiditetit dhe rrjedhjes së parasë</i> |                                   |   |                                       |   |
| Koeficienti aktual (qarkullues)                         | 1.54                              |   | 1.74                                  | ✓ |
| Koeficienti i shpejtë                                   | 1.01                              |   | 1.08                                  | ✓ |
| Ditët e llogarive të arkëtueshme                        | 88.84                             |   | 81.81                                 | ✓ |
| Ditët e llogarive të pagueshme                          | 90.71                             | ✓ | 98.71                                 |   |
| Ditët e stoqeve   | 77.75                             | ✓ | 94.12                                 |   |

#### **Informatat thelbësore 1 pikë**

Në vitin tonë të parë, kompania jonë ka demonstruar performancë që mund të konsiderohet e suksesshme, veçanërisht në performancën e tregueseve dytësor të profitabilitetit, tregueseve të levës dhe në disa tregues të rrjedhjes së parasë (efikasitetit). Ndërsa treguesit parësor të profitabilitetit, treguesit e likuiditetit dhe ditët e LI/A (tregues i efikasitetit) kompania konkurrense qëndron më mirë se kompania 'Darda', edhe pse shumica e këtyre tregueseve janë shumë konkurruese.

#### **Konkluzioni 1 pikë**

Për të ardhmen duhet më tepër përqendruar në efikasitetin operacional për të mbështetur përfitimin (profitabilitetin) që kanë të bëjnë me treguesit parësor të profitabilitetit, të rishikohet performanca në baza të rregullta tremujore për të gjurmuar përparimin dhe për të marrë vendime të bazuara në të dhëna. etj.

#### **Rekomandimi 1 pikë**

Jemi të gatshëm për sqarime shtesë nëse ka nevojë.

Me respekt,

Menaxheri Financiar ose Kontabilisti menaxherial

**Vërejtje për vlerësuesin:** Në këtë raport vlerëson elementet dhe strukturimi i raportit, jo domosdoshmërisht përputhshmëria e fjalive të prezantuara në Raportin e sugjeruar.